



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Primjen / Prodato Received / Delivery	30.03.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSHCK	1743/2022		111



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 45 /2022

Datë: 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Këshilli) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Komunë të Gjilanit.
2. Kryetarit të Komunës së Gjilanit obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.


Jeton KOCA
Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunë të Gjilanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-se;



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Prenuar / Dorezuar Primljen/Prodato Received/Delivered		30.03.2022		2		viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojcë Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity				
SKPMSHCK	1743/2022		1115				

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**RAPORTI I MONITORIMIT LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE
PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVILË**

NË

KOMUNËN E GJILANIT

Prishtinë, 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Monitorimit.....	3
Objektiva dhe metodologjia e monitorimit.....	3
Fushat e monitorimit.....	4
Raporti për monitiromin në Komunën e Gjilanit.....	5-8
Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....	9
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....	10
Procedurat Disiplinore.....	10
Procedurat e Ankesave.....	10
Procedurat e Vlerësimit.....	10
Procedurat e Pushimeve.....	11
Procedurat e Transferimit.....	12
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	13
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....	13
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	14
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	14
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	14
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	14
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	14
Ngacmimet Seksuale.....	15
Shënimet/komentet/konkluzionet e përgjithshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	15.

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) Monitoron Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes monitorimit të Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MONITORIMIT I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, përmes funksionit të monitorimit Këshilli bënë monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar “Udhëzuesin për procedurën e monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton “Planin e Monitorimit” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Objektiva e monitorimit ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e monitorimit janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Ngacmimet Seksuale;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT I PROCEDURËS SË MONITORIMIT LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVILË NË KOMUNËN E GJILANIT PËR VITIN 2020

Këshilli, gjatë procesit të Monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Komunën e Gjilanit për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Komuna e Gjilanit përveç monitorimit të drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Komunën e Gjilanit me datë 17 dhe 18.03.2021, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr kopjet dhe dokumentet relevante, si në vijim:

- Rregullore (KGJ) Nr.04/2017 për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale e dates 30.07.2020 me nr.protokolli 016-62879,
- E-maili zyrtar i datës 16.03.2021, lidhur me përcaktimin e statusit të zyrtareve publik të Komunës së Gjilanit, të bashkangjitur dhe listen e nëpunësve civil,
- Lista e të punësuarve të nëpunësve civil për vitin 2020 , gjithsejt 270, i datës 31.12.2020,
- Lista e ushtruesve në detyrë, gjithsejt një (1), Vendimi nr.560 i datës 08.07.2020,
- Lista e pozitive të lira për vitin 2020,
- Lista e nëpunësve civil të transferuar, për 2020,
- Vendimi nr.538 i datës 30.06.2020,për ricaktim në detyrë sipas zvoglimit të numrit të drejtorive,
- Lista e nëpunësve civil sipas strukturës etnike dhe gjinore për vitin 2020,
- Vendimi nr.86 i datës 08.02.2019,për caktim në detyrë sipas riorganizimit
- Dosja e nëpunësit civil, Udhëheqës i Sektorit për Inspektim,
- Dosja e nëpunëses civile, Zyrtare e Arsimit të Lartë në Drejtorin e Arsinit,
- Dosja e nëpunësit civil, Zyrtar për Shërbim të Qytetarëve,
- Dosja e nëpunësit civil, Zyrtar Anketues, Regjistrim të Pronës,
- Dosja e nëpunësit civil, z. Shef i Sektorit të Gjeodezisë.
- Dosjen e procedurës së rekrutimit -avancim, për pozitën “Udhëheqës i Prokurimit”, në zyrën e Prokurimit(e anuluar),
- Dosjen e procedurës së rekrutimit-avancim, për pozitën “Udhëheqës i Sektorit të Asistencës Sociale”, në DSHMS-QPS (e anuluar).
- Listën e personelit të angazhuar me kontratë për marrëveshje për shërbime të veçanta dhe të gjitha marrëveshjet për shërbime të veçanta për vitin 2020, nga data 01.04.2020 deri me date 30.09.2020, gjithsejt 26 marrëveshje kopje,
- Listën e personelit të angazhuar me kontratë për marrëveshje për shërbime të veçanta sipas shpalljes publike dhe të gjitha marrëveshjet për shërbime të veçanta për vitin 2020, nga data 01.04.2019 deri me datë 31.03.2020 dhe nga data 01.04.2020 deri me date 30.09.2020, gjithsejt 26 marrëveshje kopje.
- Shpallja e konkursit për avancim i datës 01.07.2020 nr.02-016-51850 “Udhëheqës i Prokurimit”, “Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenies Sociale”, “Zyrtar për biblioteka 1”,
- Njoftim i datës 02.02.2021, për procedurën e prokurimit për punësim për shërbime të veçanta,
- E-maili i datës 15.12.2020, për informim lidhur me angazhimin e personelit për shërbime të veçanta,
- Vendim nr.1141 i datës 03.12.2020 për anulimin e pjesërishtëm të konkursit publik, “Udhëheqës i Sektorit Ligjor”, i datës 30.06.2020 nr.02-016-51400,
- Vendim nr.827 i datës 16.10.2020 për anulimin e pjesërishtëm të konkursit publik, “Teknik i pylltarisë për mbrojtje dhe monitorim me nr. Ref.RN0000615”, i datës 30.06.2020 nr.02-016-51400,

- Vëndimi nr.1141 i datës 03.12.2020 për anulimin e pjesërishëm të konkursit publik, "Udhëheqës i Sektorit për mirëqenies sociale", i datës 01.07.2020 nr.02/-016/-51840,
- Vendimi nr.589 i datës 20.07.2020, për anulimin e pjesërishëm të shpalljes për avancim në karrierë, "Udhëheqës i prokurimit", i publikuar me datës 02.07.2020 në web faqe, kurse vazhdon procedura për pozitën" zyrtar për biblioteka 1",
- Konkursi i jashtëm i shpallur për tetë (8) pozita, me datës 30.06.2020nr.02-016-51400, "Udhëheqës i Sektorit ligjor", "Inspektor i ndertimit", "Zyrtar për shërbime sociale 2", "Zyrtar për gjendje civile 1", "Zyrtar për buxhet dhe financa 1", "Teknik i pylltarisë për mbrojtjen dhe monitorim", "Zyrtar për gjeodezi", "Asistent administrativ 3",
- **Dosja e procedurës së rekrutimit për avancim në karrierë i datës 01.07.20 "Zyrtar për biblioteka 1" "Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale", dhe Udhëheqës i Prokurimit,**
- Autorizimi i datës 29.06.2020, RN00006036, Konfirmimi për qëndrueshmëri të buxhetit i datës 26.06.2020 nr.532, Kërkësës se datës 05.06.2019,
- Shpallja e konkursit për avancim në karrierës i datës 01.07.2020 me nr.02-016-51850,
- Aplikacioni, te dates 06 dhe 08 .07.2020,
- Raporti i listës së shkurtër i datës 13.07.2020,
- Njoftimi nr.02-016-95561 i datës 16.10.2020, për testim me shkrim, Rezultatet e testit me shkrim i nxjerr nga ISMBNJ, dhe Ftesa për testim me gojë per date 28.10.2020,Përmbledhja e vlerësimeve individuale Form-MAP-SHCK, Renditja përfundimtare e kandidatëve Form.MAP-SHCK, Raporti final i rekomandimit nga komisionit rekrutues Form.MAP-SHCK-11,
- Raporti nr.1037 final i rekomandimit nga komisionit rekrutues, i datës 04.11.2020,
- Akt emerimi nr.02-016-123287 i datës 01.10.2019,
- Akt emerimi nr.02-016-19971 i datës 22.07.2011,
- Akt emerimi nr.02-016-0086749/17 i datës 22.08.2017,
- Akt emerimi nr.02-016-20551 i datës 25.07.2011,
- Akt emerimi nr.02-016-132428 i datës 30.11.2012,
- Akt emerimi nr.02-016-20582 i datës 25.07.2011,
- Akt emerimi nr.02-016-58787 i datës 23.06.2015,
- Akt emerimi nr.02-016-17276 i datës 15.02.2012,
- Akt emerimi nr.02-016-53057 i datës 30.05.2018,
- Raporti vlerësimit i nxjerrë nga testi me shkrim i datës 20.11.2020, për pozitën"Udhëheqës i Sektorit për mirëqenies sociale" dhe "Udhëheqës i prokurimit",
- Vendim nr.207 i datës 26.03.2017, për Themelimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave,
- Vendimin me numër 272 të datës 27.04.2017 për vazhdimin e periudhës së emërimit Komisionit për Procedurën Disiplinore; Vendimin me numër 103 të datës 01.03.2021 për Themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimi nr.02-016/90428/2 i datës 08.10.2020 nga Njësia e burimeve njerezore, sipas ankeses se rekrutimit,Vendimi nr.02-016/91568/2 i datës 08.10.2020 nga Njësia e burimeve njerezore, sipas ankeses se rekrutimit, Vendimi nr.02-016/90932/2 i datës 08.10.2020 nga Njësia e burimeve njerezore, sipas ankeses se rekrutimit,Vendimi nr.02-016/90121/2 i datës 08.10.2020 nga Njësia e burimeve njerezore, sipas ankeses se rekrutimit,Vendimi nr.02-016/91170/2 i datës 08.10.2020 nga Njësia e burimeve njerezore, sipas ankeses se rekrutimit,Vendimi nr.02-016/90135/2 i datës 08.10.2020 nga Njësia e burimeve njerezore, sipas ankeses se rekrutimit,Vendimi nr.02-016/90987/2 i datës 08.10.2020 nga Njësia e burimeve njerezore, sipas ankeses se rekrutimit,Vendimi nr.02-016/91165/2 i datës 08.10.2020 nga Njësia e burimeve njerezore, sipas ankeses se rekrutimit,
- Lista e zyrtarëve të pezullar nga puna –shtator 2020,
- Vendimi nr.781 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,

- Vendimi nr.02-016-211744 i datës 15.03.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.785 i datës 105.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.778 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.784 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.771 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.775 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.785 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.774 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.782 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.779 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.778 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.772 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.727 i datës 18.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.770 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.786 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.773 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.780 i datës 05.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.789 i datës 10.07.2019 , për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.828 i datës 18.10.2016, për pezullim parandalues,
- Vendimi nr.804 i datës 12.10.2016, për pefundim të marrëdhënies së punës(me vdekjen e NC),
- Lista e nëpunësve civil që dalin në pension për vitin 2020,
- Vendimi nr.29 i datës 17.01.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës-pensionim,
- Vendimi nr.145 i datës 25.02.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës-pensionim,
- Vendimi nr.454 i datës 21.05.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës-pensionim,
- Vendimi nr.142 i datës 25.02.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës-pensionim,
- Vendimi nr.648 i datës 19.08.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës-pensionim,
- Vendimi nr.1174 i datës 08.12.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës-pensionim,
- Vendimi nr.02-016-14882 i datës 10.02.2021, për konfirmimin e periudhës provuese,
- Formulari për vlerësimin e punës provuese, Akt emerimi nr.02-016/20608 i datës 24.02.2020,
- Vendimi nr.111 i datës 20.02.2020, për pushim të lehonis,
- Vendimi nr.633 i datës 11.08.2020, për pushim të lehonis,
- Vendimi nr.626 i datës 11.08.2020, për pushim të lehonis,
- Vendimi nr.1047 i datës 07.10.2019, për pushim të lehonis,
- Forma nga SIMBNJ, për kërkesat e pushimeve,
- Lista e nëpunësve të larguar, me Vendimin Nr.804 i dtaës 12.10.2020 me rastin e vdekjes,
- Lista e nëpunësve civil me pezullim të dakorduar për vitin 2020, me vendimet e bashkangjitura,
- Vendimi nr.113 i datës 20.02.2020 për lejimin e pushimit pa pagesë,
- Vendimi nr.618 i datës 04.08.2020 për lejimin e pushimit pa pagesë,
- Vendimi nr.593 i datës 20.07.20202 për lejimin e pushimit pa pagesë,
- Vendimi nr.594 i datës 20.07.2020 për lejimin e pushimit pa pagesë,
- Vendimi nr.359 i datës 22.05.2019 për lejimin e pushimit pa pagesë,
- Vendimi nr.415 i datës 08.05.2020 për lejimin e pushimit pa pagesë,
- Vendimi nr.815 i datës 14.10.2020 për pezullim të marrëdhënies së punës, sipas detyrës zyrtare,
- Lista e nxjerre nga dosja e pushimeve mjeksore, vjetore nga SIMBNJ, për vitin 2020,
- E-maili zyrtar i datës 15.12.2020 nga Njësia e personelit, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil,
- Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nëpunesve të shërbimit publik për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional, i datës 20.01.2021,

- Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimit publik për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional, i datës 28.01.2021,
- Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimit publik për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional, i datës 02.02.2021,
- Aktgjykim PKR.nr.33/19 i datës 02.12.2020, nga Gjykata Themelore në Gjilan, Vendimi nr.02-221 i datës 10.03.2020, për caktimin e nëpunësit civil në pozitën e njëtrikthim në punë para pezullimit, Akt emerimi nr.02-016-51840 i datës 01.07.2020, Vendimin nr.02-287 e datës 17.03.2018 për pezullim parandalues,
- Plani vjetor i trajnimeve të nëpunësve civil për periudhën janar - dhjetor 2020.

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e monitorimit të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka realizuar në Komunën e Gjilanit, me datë 17 dhe 18.03.2021, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren (KGJ) Nr.04/2017 për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale të datës 30.07.2020 me nr.protokolli 016-62879, e cila është duke u zbatuar, dhe po ashtu janë nxjerrë aktë emërimet në pajtim me organizimin e brendshëm të vendeve të punës. Në këtë institucion janë të punësuar 339 nëpunës civil, ndërsa 16 pozita janë të lira.

- Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka shqyrtuar dosjet e personelit dhe ka konstatuar se janë shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil ndërsa si kopje janë marrë dy (2) dosje atë për pozitën “Zyrtar për Evidencimin e Pronës së palujtshme”, “Zyrtar për Arsim të Mesëm të Lartë”, dhe në bazë të vlerësimit të gjitha dosjet personale janë të ruajtura në sirtar të sigurt, mirëpo në bazë të shqyrtimit të dosjeve është konstatuar që dosjet e personelit kanë qenë të kompeletuara pjesërisht, sepse disa raste nuk janë përfshirë në dosje kërkesa e pushimeve, formularët e vlerësimit të rezultateve në punë dhe formularët e përmbajtjeve të dosjeve personale të nëpunësit civil, repsketivisht fletën prezantuese.
- Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion ka pasur një (1) pozita me ushtrues detyre, mirëpo pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, asnjë nga pozitat e lira që kaanë qenë me ushtrues detyre nuk janë si të tilla.
- Bazuar në deklaratimet e Udhëheqësit të Njësies së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, kjo komunë ka dërguar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, listën për deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë, mirëpo ende nuk ka përfunduar si proces.

Kolegji gjatë shqyrtimit të kësaj fushe ka gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për monitorim, zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të personelit, ka konstatuar që dosja për pozitën 1. “Udhëheqës i Sektorit të Inspektimit”, 2. “Zyrtarë të Arsimit të Lartë”, 3. “Zyrtar për Shërbim të Qytetarëve”, 4. “Zyrtar Anketues dhe Regjistrim të Pronës” dhe 5. “Shefit të Sektorit të Gjeodezisë”, në dosje nuk janë

formularët e vlerësimit të rezultateve në punë. Në dosje të personelit nuk janë të vendosur kërkesat e pushimeve pasi që në këtë institucion evidenca e pushimeve mbahet vetëm në mënyrë elektronike. Po ashtu dosjet e personelit nuk e përmbajnë formularin e përmbajtjes së dosjeve personale të nëpunësit civil, respektivisht fletën prezantuese, më këtë Kolegji vlerëson se nuk janë respektuar dispozitat e nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1 dhe 1.17 të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civil, dhe dispozitat e nenit 4 paragrafit 3 të Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, respektivisht shtojcës 1.1 pika 17 të kësaj rregulloreje, sepse dosja personale e zyrtarit publikë duhet të shoqërohet nga fleta prezantuese e krijuar nga zyrtari përgjegjës i Njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila ka formën dhe përmbajtjen sipas shtojcës nr.1.2, ndërsa Fleta prezantuese sipas paragrafit 3 të këtij neni nënshkruhet nga zyrtari i autorizuar i njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës dhe nga vetë zyrtari publik, për të cilin është krijuar dosja personale, e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni. Po ashtu dosjet e personelit duhet të jenë të kompletuara, sipas përmbajtjeje që kërkohej në shtojën 1.1 të kësaj rregulloreje.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes së lartcekur, që të gjitha dosjet e personelit të jenë në pajtium me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për monitorimi e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë procedurës së shqyrtimit të dosjeve dhe deklarimit të Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, ka konstatuar se për vitin 2020 ka pasur vetëm një pozitë me ushtrues detyre respektivisht , pozita “Udhëheqës i Prokurimit”, e cila pozitë është ushtruar tre (3) muaj, në pajtim me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Kolegji gjatë monitorimit ka kontatua se pas hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka filluar të aplikohet më datë 09.07.2020 (sipas Aktykimit nr. KO203/19, Publikuar: 13.07.2020, Gjykatës Kushtetuese), në Komunë të Gjilanit, është zbatuar dispozita e nenit 83 paragrafi 10, me rastin e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Në këtë fushë nuk kemi të gjetura dhe nuk kemi dhënë rekomandime.

E GJETURA 3: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në Komunën e Gjilanit, në pyetjen e bërë Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore se a është përfunduar deklarimi i statusit të zyrtarëve publikë, kemi pranuar përgjigje që lista e zyrtarëve është dërguar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mirëpo ende nuk ka përfunduar si proces. Lidhur me këtë, Kolegji konstaton se deklarimi i statusit të zyrtarëve publikë ka qenë obligim ligjor që të përfundohet brenda afateve ligjore të përcaktuar me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të A të Komunës së Gjilanit në bashkëpunim me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë, sipas dispozitave të nenit 83 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, të arsyetuar me vendim sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për monitorimit të zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, ka përgatitur planin e personelit dhe gjatë vitit 2020. Në këtë institucion janë zhvilluar tetë (8) procedura të rekrutimit të jashtëm dhe 2 shpallje të konkurse për avancim për 4 pozita, të cilat janë zbatuar konform njoftimit të datës 10.01.2020 të Ministrisë së Administratës Publike, që nga kjo datë të rikthehet së zbatuari Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me rastin e pezullimit të Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, deri në korrik të vitit 2020.

Gjatë monitorimit në Komunën e Gjilanit Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar dosjen e rekrutimit ka marrë si mostër për të shqyrtuar procedurën e rekrutimit për avancim, i shpallur me datë 01.07.2020, për pozitën *“Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale”*, dhe *“Udhëheqës i Prokurimit”*, të cilat janë anuluar sipas mostrave të lëndës me dy Vendimet nr.818 të datës 16.10.2020 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit dhe Vendimin nr.589 të datës 20.07.2020, për shkak se kanë aplikuar me pak se tre kandidatë që i plotesojnë kriteret e konkursit.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar dhe dosjen e konkursit të jashtëm të datës 30.06.2020, që janë shpallur gjithsej 8 pozita, dhe prej tyre si mostër Këshilli ka shqyrtuar pozitën *“Udhëheqës i Sektorit Ligjor”* dhe *“Teknik i pylltarisë për mbrojtje dhe monitorim”*, të cilat janë anuluar me datë 03.12.2020 me Vendimin nr.1141, duke arsyetuar se anulimi bëhet për shkak të riorganizimit të sektorit ligjor, po ashtu edhe Vendimi nr.827 i datës 16.10.2020 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit për pozitën e dytë, për shkak se komisioni nuk ka mundur të identifikojë tre kandidatë që i plotesojnë kriteret e konkursit.

Për këto procedura të avancimit dhe rekrutimit, nuk kemi të gjetura dhe nuk kemi dhënë rekomandime.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, në bazë të Vendimit Nr.02/272 të datës 27.04.2017 ka të themeluar Komisionin Disiplinor i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar, i cili është në pajtim me nenin 70 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kurse pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publikë, Komuna e Gjilanit me datë 01.03.2021 ka nxjerr Vendim Nr.02/103 për themelimin e Komisionit Disiplinor, me tre anëtar me mandat tre (3) vjeçar.

Gjatë vitit 2020 në Komunën e Gjilanit, nuk ka zhvilluar procedura disiplinore dhe nuk ka shqiptuar masa disiplinore.

Lidhur me këtë fushë Kolegji ka gjetur se:

E GJETURA 1: Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit Nr.02/103 të datës 01.03.2021 për themelimin të Komisionit Disiplinor, ka konstatuar se tek anëtarët e komisionit është përshkruar vetën “kryesues dhe anëtarët”, ndërsa nuk janë përshkruar pozitat e kryesuesit dhe anëtarëve të këtij komisioni. Bazuar në nenin 49 paragrafin 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka përcaktuar se Qeveria, me propozimin e Ministrisë Përgjegjëse për Administratën Publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, janë miratuar rregullat që përcaktojnë mënyrën e themelimit të komisionit disiplinor, citoj: *“Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist*

dhe ka këtë përbërje: Nëpunës civil i nivelit drejtues-Kryesues i Komisionit; Nëpunës civil i nivelit profesional-anëtar dhe Nëpunës civil i njësish së burimeve njerëzore-anëtar”. Meqenësë kjo dispozitë ka përcaktuar që duhet të përshkruhen edhe pozitave të kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor, mbi këtë bazë Komuna e Gjilanit, nuk ka bërë një përshkrim të tillë në bazë të obligimit ligjor, dhe kjo dispozitë nuk është zbatuar në tërësi.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Gjilanit që bëjë plotësim/ndryshimin e vendimit të Komisionit Disiplinor, duke bërë përshkrimin e pozitave që mbajnë kryesuesi dhe anëtarët e komisionit, siç parashihet me nenin 10 të Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, në bazë të Vendimit me numër protokoll 02/207 të datës 26.03.2019 ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i cili është i themeluar prej tre (3) anëtarëve të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar, në bazë të vlerësimeve në këtë komisioni gjatë vitit 2020, nuk ka pasur ankesa të paparshtuar për të shqyrtuar, gjatë periudhës së Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në këtë fushë nuk kemi të gjetura dhe nuk kemi dhënë rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se personat përgjegjës në Komunë të Gjilanit, nuk ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil, sepse gjatë monitorimit Njësia e personelit ka deklaruar se pesë (5) nëpunësve civil nuk ju është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2020. Për pesë (5) nëpunës civil të pa vlerësuar, ju janë marrë Akte emërimet, kurse për nëpunës civil që kanë qenë në periudhë provuese gjatë vitit 2020, është konstatuar se është bërë vlerësimi i periudhës provuese. Kolegji ka konstatuar që janë respektuar afatet për vlerësim të punës provuese për nëpunësit civil që kanë qenë në këtë periudhë, siç parashihet me Kapitullin III respektivisht nenin 37 dhe 38 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë fushë kolegji ka gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për pesë(5) nëpunës civil që nuk janë vlerësuar për rezultate e punës për vitin 2020 edhe pse Njësia e personelit në Komunën e Gjilanit ka përcjell shkresën zyrtare për drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e drejtpërdrejtë të nëpunësve civil, që vlerësimi i rezultateve të punës duhet të bëhet deri brenda afateve ligjore, në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil është shkelje e dispozitave të 43 Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullore Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Gjilanit, që në bazë të konstatimeve dhe të gjeturave të Kolegjit gjatë monitorimit, për fushën e vlerësimit të rezultateve në punë, të ndërmer veprimet e duhura lidhur me zbatimin e plotë të dispozitave ligjore për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil të pa vlerësuar, dhe se të gjithë Udhëheqësit e Drejtpërdrejtë të nëpunësve civil, të obligohen që të përfundojnë obligimin e tyre ndaj nëpunësve civil, në pajtim me dispozitat e nenit 43 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se gjatë monitorimit të dosjeve të personelit ka gjetur se ka formular të vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2020 që është kryer jashtë afatit ligjor respektivisht në muajin shkurt 2020, që rezulton se nuk janë respektuar afatet ligjore të përcaktuar me nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 8 paragrafi 2 të Rregullore Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, sepse vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësi civil, do të duhej të përfundoj deri më datë 31 Janar të vitit të ardhshëm për vitin paraprak, dhe në këtë rast nëse nuk bëhet përfundimi i vlerësimit të rezultateve në punën për nëpunësit civil brenda kësaj periudhe, konsiderohet heshtje administrative dhe heshtja e tillë në bazë të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për nëpunësit civil të pa vlerësuar mund ti njihet vlerësimi i njëjt me atë të vitit të fundit, për vitin paraprak, nëse udhëheqësi i drejtëpërdrejt nuk ka bazë ligjore të arsyeshme për mos kryerjen e obligimit të tij ligjor lidhur me mos kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë, të nëpunësve civil.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Gjilanit dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore, që të komunikojë me mbikëqyrësit e drejtëpërdrejt të nëpunësve civil, që të gjitha vlerësimet e rezultateve në punë të bëhen brenda afateve të përcaktuar me nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 8 paragrafi 2 të Rregullore Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në kopje fizike dhe elektronike, kurse evidencën e pushimeve mjekësore nuk e mbajnë edhe pse në dosje janë vendosur shendjat mjekësore gjegjesisht raportet. Evidenca e pushimeve egziston vetëm në formë elektornike te SIBMNJ. Në dosje të personelit kanë qenë të vendosura shenjat mjekësore. Shtatë (7) nëpunës civil kanë realizuar pushim pa pagesë në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, katë (4) nëpunëse civil kanë realizuar pushimin lëhonisë prej tyre një (1) në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës ndërsa tri(3) në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe në bazë të shqyrtimit të dosjeve kanë qenë të vendosura vendimet, në këtë rast tek procedurat e pushimeve të lartcekura janë respektuar dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Mirëpo tek pushimet vjetore, Kolegji gjatë shqyrtimit të dosejsve ka vërejtur se nëpunësit civil edhe pse realizojnë pushimet vjetor, kërkesat i bëjnë përmes sistemit SIBMNJ, po të njëjtat nuk janë sjellur edhe në formë fizike.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, gjatë vitit 2020, ka pasur tri (3) transferim të përhershëm të cilat janë bërë të brendshme me arsyetimin e riorganizimit e brendshëm të shërbimit civil të Komunës, në bazë të nenit

28 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, ka të punësuar 324 nëpunës civil prej tyre 296 janë Shqiptar, 21 Serb, 5 Turq, 1 Boshnjak dhe 1 Rom, prej 324 të punësuar nëpunës civil, 107 femra dhe 217 janë meshkuj, kurse nëpunës civil të punësuar me aftësi të kufizuara janë dy (2). Në bazë të vlerësimit të të dhënave kemi konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 324 nëpunësve civil të punësuar në Komunën e Gjilanit, 107 prej tyre janë femra dhe 217 janë meshkuj, që në rastin konkret është konstatuar se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

Rekomandim 1: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Gjilanit, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 324 nëpunësve civil të punësuar në Komunën e Gjilanit, edhe pse prej tyre janë të punësuar vetëm dy (2) personat me aftësi të kufizuara, dhe se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, pasi që për çdo 50 të punësuar në shërbim civil, një do të duhej me qenë person me nevoja të veçanta, edhe pse Komuna e Gjilanit ka dy të punësuar me aftësi të kufizuara dhe nuk e ka përmbushur mjaftueshëm numrin e të punësuarve për qindjen e të punësuarve me aftësi të kufizuar në raport me numrin e të punësuarve në shërbimin civil.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Gjilanit, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) të punësuar.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Gjilanit, në bazë të vlerësimit të dosjeve të vitit 2020, kanë pasur pesë (5) nëpunës civil me pezullim të dakorduar nga marrëdhënien e punës në shërbimin civil, nuk kanë raste të pushimit pa pagesë, kanë dy(2) raste të nëpunësve civil që kanë marr detyrën e funksionarit publik, 26 nëpunës civil me pezullim parandalues, një(1) nëpunës civil që ju ka ndërprerë marrëdhënien e punës (me vdekje). Dhjetë(10), nëpunësve civil përfundimi i marrëdhënies e punës me rastin e pensionimit, të cilëve i është bërë pagesa e një page të njehershme në pajtim me legjislacionin në fuqi, po ashtu asnjë nëpunës civil nuk i është përfunduar marrëdhënien e punës për shkak (ushtrimit të detyrave për arsye shëndetësore, përfundimit të afatit për punës me afat të caktuar).

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Gjilanit nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mbanë pozitë të nëpunësit civil dhe ndonjë post publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Gjilanit, për vitin 2020 kanë pasur një rast të nëpunësi civil, që është zhvilluar procedurë penale, pozita "Udhëheqës i prokurimit", në kuadër të Zyrës së Prokurimit, i cili ka qenë në pezullim parandalues nga data 12.03.2018 deri me datë 09.03.2020, dhe me rastin kur nëpunësi është liruar nga anktakuza i njëjti është rikthyer në punën dhe në detyrat e tija ku ka qene duke ushtruar poziten e tij para pezullimit prandalues, sipas Vendimit të datës 10.03.2020 i nxjerre nga Kryetari i Komunës së Gjilanit, në pajtim me nenin 69 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, ka planin individual të trajnimeve për secilin nëpunës civil, duke përfshirë trajnimet e parapara nga plani i Institutit të Kosovës për Administratë Publike dhe po ashtu nuk ka evidencë të nëpunësve civil që kanë ndjekur trajnimet, kurse për trajnime jasht vendit dhe me pagesë nuk kanë pasur raste.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Gjilanit, Planin Individual i Trajnimeve ekzistoin siç është e pëcaktuar në Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, dhe me Manualin e Metodologjisë së Vlerësimit të Nevojave për Trajnim në SHCK (Formulari 3) pasi që trajnimet janë pjesë e përgatitjes sa më të mirë të nëpunësve civil lidhur me përgjegjësit dhe detyrat e tyre, mirpo evidenca e nëpunësve që kanë ndjekur trajnimet nuk është mbajtur nga Njësia e personelit në Komunë të Gjilanit.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës dhe Menaxherin e Personelit të Komunës së Gjilanit, që të ndërmarr të gjitha veprimet pasi që për çdo nëpunës civil duhet të jetë i përgatitur plan individual i trajnimeve siç përcaktohet me Manualin e Metodologjisë së Vlerësimit të Nevojave për Trajnimin në SHCK dhe po ashtu duhet pasur informata të sakta lidhur me trajnimet e nëpunësve civil.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, vijimin në punë e mbanë në formë elektronike për mes sistemit SIBMNJ-së, ka evidencë. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

14. NGACMIMET SEKSUALE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunë të Gjilanit, nuk ka pasur raste të ngacmimit seksual në vendin e punës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

15. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, gjatë vitit 2020 ka pranuar 4 vendime të Këshillit, prej tyre tri (3) ka qenë refuzim kurse një(1) aprovim obliguar të zbatoj, ndërsa Komuna e Gjilanit në vitin 2017 është monitoruar për vitin 2016 dhe është dhënë tri (3) rekomandime, nuk janë adresuar zbatimi i tyre në Këshill.

16. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të të dhënave të dosjeve për fushat e monitorimit, ka konstatuar njëmbëdhjetë (11) të gjetura dhe ka dhënë njëmbëdhjetë (11) rekomandime, në këtë kuptim Komuna e Gjilanit, ka arritur pjesërisht që të zbatojë rregullat dhe parimet e legjislacionit të shërbimit civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Komunës së Gjilanit, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Gjilanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK


Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional